Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 920/20
Datë/Datum. 20.11.2020
PRISHTINË - PRIŠTINA

DATË/A:	20 NËNTOR 2020
REFERENCË:	920/20
PËR/ZA/TO:	AK- "Kuvendi Komunal Shtime"
NGA/OD/FROM:	Blerim Dina Kryetar i OSHP -së
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	NJOFTIM

Operatori ekonomik - **"MEGRANT ING " SH.P.K & "LUMEJTË HAVOLLI BLAKCORI" B.I – Prishtinë ,** si palë e pakënaqur me datën: 11.11.2020, kanë parashtruar në OSHP ankesën me numër 920/20 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **"Ndërtimi i Shtatores së Komandantit Adem Jashari"** me nr. të prokurimit: **617-20-4196-4-2-3** dhe nr. te brendshëm: **617-2020-053-423**, duke pretenduar se AK ka shkelur këto dispozita ligjore:

- 6, 7, 10, 51, 56, 57, 59, 60, 65, dhe 70 të LPP-së si dhe nenin 41 te RRUOPP-së

Organi Shqyrtues i prokurimit, pas pranimit të anekses, në bazë të nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë 13 Nëntor 2020 kanë autorizuar ekspertin profesional të prokurimit për të shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

Eksperti profesional i prokurimit me datën 18 Nëntor 2020 ka dorëzuar raportin e ekspertizës dhe ka konstatuar që ankesa e OE ankues **të aprovohet si e bazuar, rrjedhimisht te anulohet propozimi për dhënie te kontratës (Njoftimi mbi Vendimin e AK) dhe Aktiviteti i Prokurimit te kthehet në RIVLERËSIM.**

Autoriteti kontraktues- **"Kuvendi Komunal Shtime"** me datën 18 Nëntor 2020 kanë pranuar mendimin e ekspertit profesional të prokurimit dhe të njëjtit me datën 19 Nëntor 2020 përmes parashtresës me shkrim kanë njoftuar panelin shqyrtues të OSHP-së se **PAJTOHEN** ku sqaron se do ta respektojnë mendimin e dhënë në raportin e ekspertizës dhe me vendimin e OSHP-së dhe do ta kthejmë lenden ne rivlerësim.

Operatori ekonomik ankues **"MEGRANT ING " SH.P.K & "LUMEJTË HAVOLLI BLAKCORI" B.I – Prishtinë** me datën 18 Nëntor 2020 kanë pranuar mendimin e ekspertit profesional dhe të njëjtit me datën 19 Nëntor 2020 përmes parashtresës me shkrim kanë njoftuar panelin shqyrtues të OSHP-së se **PAJTOHEN** me mendimin e dhënë në raportin e ekspertizës.

Paneli shqyrtues njofton operatorin ekonomik ankues dhe autoritetin kontraktues se konform nenit 115 pika 3 i LPP-së që procedura e ankesës përfundon në këtë fazë. Autoriteti kontraktues - **"Kuvendi Komunal Shtime"** për aktivitetin e prokurimit **"Ndërtimi i Shtatores së Komandantit Adem Jashari"** me nr. të prokurimit: **617-20-4196-4-2-3** dhe nr. te brendshëm: **617-2020-053-423 , të aprovohet si e bazuar, rrjedhimisht te anulohet propozimi për dhënie te kontratës (Njoftimi mbi Vendimin e AK) dhe Aktiviteti i Prokurimit te kthehet në RIVLERËSIM**, konform mendimit te dhënë ne raportin e ekspertizës.

Paneli shqyrtues obligon autoritetin kontraktues që në afat prej dhjetë (10) ditësh ta njoftojë me shkrim panelin shqyrtues lidhur me të gjitha veprimet e ndërmarra për këtë aktivitet të prokurimit.

Operatorit ekonomik **"MEGRANT ING " SH.P.K & "LUMEJTË HAVOLLI BLAKCORI" B.I – Prishtinë** konform nenit 118 pika 3 të LPP-së i kthehet sigurimi i ankesës. Urdhërohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 31 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.